



Planuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	01.09.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Hi Prot Bi Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRINTSHK	5070/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.695/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë dhe Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2147/2021 të datës 30.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me Anr.695/2021 të datës 28.07.2021 të parashtruar nga ankuesi për mes adresës elektronike E-maili: të cilin e përfaqëson avokati me kundër organit të punësimit-

Ministria e Punëve të Brendshëm, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.09.2022, mori këtë:

### V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.695/2021 e datës 28.07.2021, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme sipas njoftimit të datës 24.05.2021 ka publikuar konkursin me numër të procedurës RN00006948 për pranim të mbyllur për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1", në Ministrinë e Punëve të Brendshme me afat të aplikimit nga data 23.06.2021 deri me date 08.07.2021.

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas ndryshimit të Akt emërimit të datës 19.01.2018 në pozitën, "Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave", me date 07.12.2020 Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nxjerr Vendim me numër protokollit 1103, me të cilin i aprovon ankuesit pushim pa



pagesë prej nje (1) viti, duke filluar nga data 03.12.2020 deri me datë 01.12.2021 sipas kërkesës së tij me numër protokoli 1085 me arsyetimin për ngritje profesionale.

Ankuesi me date 06.07.2021 ka aplikuar ne konkursin e publikuar sipas njoftimit të datës 24.05.2021 me numër të procedurës RN00006948 për pranim të mbyllur për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1", në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimin në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 22.07.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.3/2021 me të cilin ankuesit i ka refuzuar aplikimin për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1", në Ministrinë e Punëve të Brendshme me arsyetimin se i njëjti gjendet në pushim pa pagës dhe nuk është duke e ushtruar pozitën e nëpunësit civil.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me Nr.3/2021 të datës 22.07.2021, ka parashtruar ankesë me datë 23.07.2021 tek Njësia Përgjegjëse, ndërsa Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimin në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 27.07.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.2/2021 përmes të cilit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi

Ankuesi kundër këtij vendimi, me datë 28.07.2021 parashtron ankesë me numër protokoli 3958/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se me rastin e refuzimit të aplikacionit të tij janë shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, respektivisht me pretendime ankimore që të anulohet Vendimi me Nr.2/2021 i datës 27.07.2021, si dhe kërkon që ankuesi të vazhdoj procedurën e vlerësimit të njohurive ne procedurën e rekrutimit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.08.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa me datë 10.08.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat të lëndës në këtë procedurë administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi më datë 09.09.2021 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative më datë 30.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.2147/2021, të me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 09.09.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që të vendos për ankesën e ankuesit.



*Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:* Aktgjykimin me numër A.nr.2147/2022 të datës 30.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative; Ankesa me numër Anr.695/2021 e datës 28.07.2021, Plotësim i ankesës e datës 10.09.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokati Autorizimi i datës 10.09.2021; Ndryshim i akte emërimit i datë 19.01.2018; Vendimi Nr.3/2021 i datës 22.07.2021; Ankesa e datës 23.07.2022 për njësinë përgjegjëses në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimi Nr.02/2021 i datës 27.07.2021, nga Udhëheqësi i Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit -DMZP; Vendimi nr.1103 i datës 03.12.2020 për lejimin e pushimit pa pagesë; E-mail i datës 28.07.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 4170/2022 e datës 10.08.2021; Konkursi i datës 24.05.2021; Lista e apikuesve nxjerrë nga sistemi SIMBNJ-së me numër Nr.00006948, Lista e kandidateve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftim i datës 14.07.2021; E-mail i datës 22.07.2022; Vendim i datë 22.07.2021 nga Udhëheqësi i Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit -DMZP, për B.H, njoftimi me datës 22.07.2022 E-mail; Vendim nr.04/2021 i datë 22.07.2021 nga Udhëheqësi i Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit -DMZP, për H.B; **Aplikacioni i kandidatit B.H;** Shtojca e diplomës e datës 30.06.2015; Letër motivuese e datës 07.07.2021; Diplomë nr.34 e datës 15.01.2002; Letër motivuese e datës 01.03.2021; Letër reference e datës 25.02.2021; Certifikatë e datë 01.06.2013; Certifikatë e datës 11.03.2001; Certifikatë e datë 24 prill deri me datë 09.05.2003; Certifikatë prill 2014; Certifikatë e datë 27.09.2011; Raporti vjetor i vitit 2020; Raporti vjetor i vitit 2019; Certifikatë e datës 08.03.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vendimi nr.614/2020 i datës 06.05.2020 B.H; Vendim Nr. 244 i datës 11.03.2021; Vendim Nr.14/144 i datës 04.05.2017; Vendim i datës 21.11.2021; Certifikatë e datë 01.06.2005; Certifikatë e datë 22.11.2016; **Aplikacion i kandidatit z.H.B;** Reference e datës 18.06.2016 dhe Diplome nr.77/2017; **Aplikacioni për kandidatin znj.F.T.SH;** Letër rekomandimi i datës 12.12.2016; Diplomë Universitare e datës 25.05.2011 Nr.50; Vërtetim nr.092 i datës 07.07.2021; Diplomë Nr.896 e datës 08.11.2004 për F.K.T; Formular të rezultateve në punë e datës 31.12.219; Letër motivuese F.K.T.; Akte emërim i datës 17.10.2013; Kontratë pune e datës 18.01.2011; Akte emërim i datës 21.01.2013; Vërtetim nr.388 i datës 18.06.2021; Certifikatë e datës 23.12.2009; Certifikatë e datës 01.04.2021; Certifikatë e datës 30.05.2013; Certifikatë e datës 23.12.2009; Certifikatë e datës 09.11.2016; Certifikatë e datës 17.07.2009; Certifikatë e datës 11.08.2018; Certifikatë e datës 29.06.2017; Certifikatë e datës 29.09.2018; Certifikatë e datës 02.08.2012; Certifikatë e datës 21.04.2007; Vërtetim i datës 22.06.2021 Certifikat e datës 26.04.2012; **Aplikacioni për kandidatin z.D.K.;** Letër motivuese D.K; Diplomë e datës 21.08.2010 Rochester Neë Yourk; Diplomë e datës 04.08.2012; Vendim nr.455 i datës 30.01.2013; Formular të rezultateve në punë e datës 31.12.2019; Formular të rezultateve në punë e datës 01.01.2020; Vendim Nr.137 e datës 23.02.216; Vendim e datës 05.06.2013; Ndryshim i Aktit të emërimit i datës 19.01.2018; Akt emërimi i datës 22.05.2014; Kontratë e punës 09.10.2014; Aneks kontratë e UNDP i datës 01.12.2020; Konfirmim i regjistrimit Doktorate e datës 22.09.2015; Certifikatë e datës 24.03.1999; Letër vlerësim i njohës- dhjetor 2013; Certifikatë e datës 18.12.2015; Certifikatë e datës 29.01.2021; Certifikatë e datës 15.02.2021; Certifikatë e datës 02-6.10.2017; Certifikatë e datës 12,13-17.04.2012; Certifikatë e datës 04.11.2016; Certifikatë e datës 09.02.2021; Certifikatë e datës 07.04.2021; Certifikatë e datës 01.04.2012; Certifikatë e datës 11-15.03.2013; Certifikatë e datës 23.09.2016; Certifikatë e datës 12.01.2016; **Aplikacioni për kandidatin z.SH.SH;** Vendim Nr.167 e datës 11.07.2014; Diplomë e Trajnimit e datës 14.02.2001; Diplomë Universitare Nr.1870 e datës 30.10.2008; Diplomë e datës 26.06.2000 leshura nga Bashkësia Islame; Akt emërimi i datës 06.05.2014; Vendim Nr.198 e datës 14.06.2013; Vendim Nr.136 e datës



03.12.2020; Letër motivuese e kandidatit z.SH.SH; Vërtetim i datës 06.09.2010; Vendim Nr.570-1/2009 e datës 03.09.2009; Akt emërimi i datës 09.02.2012; Vërtetim i datës 05.11.2008; Vërtetim i datës 02.07.2021; Kontratë e punës i datës 28.01.2011; Kontratë e punës i datës 03.05.2011; Formular të rezultateve në punë e datës 31.12.2019; Formular të rezultateve në punë e datës 31.12.2021; Certifikatë e datës 10.07.2010; Certifikatë e datës 14.11.2017; Certifikatë e datës 30.10.2017; Certifikatë e datës 12.04.2017; Certifikatë e datës 12.05.2017 Shkolla e Policisë; Certifikatë e datës 26.10.2017; Certifikatë e datës 29.05.2013; Certifikatë e datës 01.03.2018; Diplomë e datës 25.09.2003 për instruktor; Certifikatë e datës 08.08.2012; Certifikatë e datës 10.02.2012; Certifikatë e datës 26.08.2011; Certifikatë e datës 19.05.2011; Certifikatë e datës 14.10.2011; Certifikatë e datës 24.01.2013; Certifikatë e datës 10.11.2017; Certifikatë e datës 01.06.2017; Certifikatë e datës 01.06.2018; Mirënjohje e datës 22.03.2019; Certifikatë e datës 11.06.2015; Certifikatë e datës 01.06.2012; Certifikatë e datës 23.10.2014; Certifikatë e datës 03.03.2016; Certifikatë e datës 30.03.2012; Certifikatë e datës 11.02.2013; Certifikatë e datës 10.12.2010; Certifikatë e datës 16.05.2012; Certifikatë e datës 29.03.2012; Certifikatë e datës 05.06.2015; Certifikatë e datës 19.04.2011; Certifikatë e datës 12.02.2018; Certifikatë e datës 04.06.2018; Vërtetim i datës 18.11.2010; Certifikatë e datës 18.03.2011; Certifikatë e datës 27.01.2016; Certifikatë e datës 06.09.2017; Certifikatë e datës 03.02.2000; Certifikatë e datës 26.07.1999; E-mail i datës 10.08.2022, Kërkesë për prova shtesë, lidhur me ankesë ankuesit drejtuar MAP-së, nga Zyrtarja e lartë për bashkëpunim Profesional në S/KPMSHCK-së; E-mail e datës 12.08.2022, Përgjigje nga MAP lidhur me kërkesë të datës 10.08.2022, Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 27.09.2021; Vendim Nr.01/2021 për vlerësimin përfundimtare të kandidateve e datës 29.09.2021; Njoftim i datës 29.09.2021; Vendim nr.14/52 i datës 29.12.2021; Vendimin me Nr. Proti:1208 të datës 09.11.2021 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se objekti i ankesës së ankuesit *është e bërë i pamundur, sepse:*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se ankuesi Dardan Koçani, sipas ndryshimit të Akt emërimit të datës 19.01.2018 ka qene i sistemuar në pozitën "Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave", në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa sipas Vendimit me numër protokollit 1103 të datës 07.12.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i është lejuar pushimi pa pagesë prej një (1) viti, duke filluar nga data 03.12.2020 deri me datë 01.12.2021 sipas kërkesës së tij me numër protokollit 1085 me arsyetimin për ngritje profesionale

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi bazën e shkresave të lëndës ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme sipas njoftimit të datës 24.05.2021 ka publikuar konkursin me numër të procedurës RN00006948 për pranimit të mbyllur për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1", në Ministrinë e Punëve të Brendshme me afat të aplikimit nga data 23.06.2021 deri me date 08.07.2021, duke u bazuar në dispozitat e nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6 paragrafin 1.4 të Rregullores (QRK) Nr.15/2020 për Pranimitin, Vlerësimin dhe Disiplinën të Nivelit të Lartë Drejtues, ku është përcaktuar që *të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të*



*kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në gjithë Shërbimin Civil*, ndërsa është përcaktuar se rezultatet e vërtetimit paraparak do të shpallen deri me datë 23.07.2021.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se në këtë procedurë kanë aplikuar pesë (5) kandidat, duke përfshirë dhe ankuesin \_\_\_\_\_ i cili me datë 22.07.2021 është njoftuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin Nr.3/2021 për mos verifikimin paraparak të ankuesit respektivisht për refuzimin e aplikacionit të ankuesit \_\_\_\_\_ me numër kod RAN0000413 të datës 06.07.2021, me arsyetimin se i njëjti gjendet në pushim pa pagës dhe nuk është duke e ushtruar pozitën e nëpunësit civil.

Ankuesi kundër refuzimit të aplikacionit me numër kod RAN0000413 të datës 06.07.2021 kishte parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimin në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimin në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nxjerr Vendim me numër Nr.2/2021 të datës 27.07.2021 me të cilin i refuzon ankesën ankuesit për të njëjtat arsye.

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, konstaton se ankuesi kundër këtij vendimi, me datë 28.07.2021 parashtron ankesë me numër protokolli 3958/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se me rastin e refuzimit të aplikacionit të tij janë shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, respektivisht ankuesi pretendon që të anulohet Vendimi me Nr.2/2021 i datës 27.07.2021, si dhe kërkon që ankuesi të vazhdoj procedurën e vlerësimit të njohurive ne procedurën e rekrutimit për pozitën „Sekretar i Përgjithshëm“ në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në shkresat e lëndës ka pranuar nga organi i punësimit Ministria e Punëve të Brendshme Vendimin me Nr. Proti:1208 të datës 09.11.2021 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilin vendim ankuesit \_\_\_\_\_ i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendim të njëanshëm si rezultat i dorëheqjes, nga data 30.11.2021 në pozitën „Drejtor i Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave“, respektivisht Kolegji sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ sipas shkresës me numër protokolli 792 të datës 01.11.2021 ka dhënë dorëheqje nga pozita e punës „Drejtor i Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave“ nga data 30.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.07.2021 lidhur mos verifikimin paraparak të ankuesit respektivisht për refuzimin e aplikacionit të ankuesit \_\_\_\_\_ me numër kod RAN0000413 të datës 06.07.2021 dhe i njëjti pretendon që të anulohet Vendimi me Nr.2/2021 i datës 27.07.2021, dhe njëkohësisht të vazhdoj procedurën e vlerësimit të njohurive ne procedurën e rekrutimit për pozitën „Sekretar i Përgjithshëm“ në Ministrinë e Punëve të Brendshme, atëherë konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me





këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, sepse ankuesi me rastin e dorëheqjes nga shërbimi civil nuk e ka statusin e nëpunësit civil andaj edhe po të vazhdonte procedura e rekrutimit ankuesi nuk do të mund të merrte pjesë sepse nga data 30.11.2021 nuk e ka statusin e nëpunësit civil sepse sipas nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë përcaktohet se: *"Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil"* dhe kështu në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Procedura administrative përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të inicuar me ankesën me numër A A.nr.695/2021 e datës 28.07.2021, e parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Anr.695/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI



Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme ;
- Arkivit të KPMSHCK- së.